

**“Gjeneral gramafoni” mbërrin në Shqipëri.
Regjistrimet e para në disqe gramafoni
të muzikës tradicionale shqiptare**

**The Gramophone arrives in Albania. The earliest recordings of
traditional Albanian music on vinyl**

Abstract: *Gramophone recordings are among the earliest sound documents of Albanian traditional music. Despite their undisputed musical and cultural value, they have been almost entirely neglected as subjects to scholarly research. This article aims to shed light on the first documented expedition of 1908 in Shkodër of The Gramophone Company, a recording company in Albania. By cross-checking several sources, a catalogue of the recorded items was compiled and supplied with the pertaining discographic data. Then, a review on the performing musicians was followed by some considerations on the repertoires. Although local urban traditional music dominates, the soundscape attained is diverse and richer than expected, including songs from the highlands, a davul and zurna ensemble (a repertoire which in the meantime has disappeared from local practice), and even the military band of the Ottoman garrison stationed in the city – a souvenir from the last days of Ottoman rule in Albania. The essay suggests that such recordings had great symbolic value but did not circulate widely and did not have an extensive market either.*

Keywords: *Gramophone Company, Shkodër, Albania, traditional music, aheng.*

1. Hyrje

Regjistrimet në disqe gramafoni janë ndër dokumentet më të hershme tingullore të muzikës tradicionale shqiptare. Megjithë interesin e padiskutueshëm të tyre në këndvështrim muzikor e kulturor, ato kanë mbetur pothuajse krejtësisht jashtë vëmendjes së studiuesve. Përsa i takon periudhës socialiste, kur etnomuzikologjia zuri rrënjë përfundimisht si disiplinë studimore e institucionalizuar në Shqipëri,¹ mund të mendohen

1 Këtu nuk nënkuptojmë që nuk pati kontribute etnomuzikologjike përpara kësaj periudhe. Përmbledhjet e Pjetër Dungut (1940) dhe Gjon Kujxhisë (1943), apo shkrimet e Injac Ndojajt e ndonjë tjetri nga mesi i viteve 1930-të e më tej, janë të

një sërë shkaqesh për këtë lënie pas dore. Ndër të tjera, si prodhime komerciale të “të huajve”, vështirë se mund të pritej që ato të merrnin vlerësimin e merituar në një kuadër ideologjik ku “i huaji” do të shihej patjetër si një “gjeneral” i ndonjëfarë lloji. I referohemi këtu filmit *Gjeneral gramafoni* (1978), ideja qendrore e të cilit se depërtimi ekonomik dhe kulturor italian ishte një prelud i mirëmenduar për pushtimin ushtarak që do të vinte më vonë, ndërtohet pikërisht nëpërmjet figurës së Albertos, agjentit të shoqërisë diskografike “La Voce del Padrone”.² Më 1985 do të shfaqej një artikull i shkurtër i Riza Hysos mbi “incizimet e para të folklorit shqiptar” në pllaka gramafoni, por ai përqendrohet vetëm në “markën” e patriotit Spiridon Ilo dhe qëndrimi ndaj regjistrimeve të kompanive kryesore diskografike (aty përmenden Columbia dhe Odeon) i përgjigjet linjës së përvijuar më sipër (shih Hyso 1980, 171).

Duhet thënë se kjo shpërfillje e regjistrimeve të hershme diskografike nuk është një dukuri ngushtësisht shqiptare. Ajo lidhet edhe me një koncept të caktuar për autenticitetin që etnomuzikologjia e trashëgoi romantizmi i shek. XIX, në themel të të cilit qëndronte tjetërsia absolute kundrejt modernitetit (shih Pennanen 2007, 108; Dimov 2022, 21), koncept i cili mbizotëroi më gjatë sidomos në ato vende ku disiplina u zhvillua sipas paradigmës së folkloristikës muzikore.

Pas ndryshimit të sistemit politik më 1990 ka patur njëfarë zgjimi të interesit ndaj këtij korpusi regjistrimesh.³ Këtu mund të përmendet punimi i studiuesit Vasil Tole (shih Tole 2001), i cili megjithëse me një fokus të gjerë, përcjell të dhëna me interes edhe për diskografinë. Digjitalizimi dhe publikimi që ky autor i ka bërë së fundmi disa regjistrimeve të sazeve të Leskovikut (shih Tole 2017) është një nga aspektet më të vlerëta të punës diskografike, e cila duhet të vijohet më tej, në mënyrë që të kemi në dorë sa më shumë copëza të mozaikut tingullor të regjistruar. Studiuesi Ferid Bala, nga ana tjetër, ka bërë analiza mjaft interesante në lidhje me stilin e interpretimit, por pa përcjellë të dhëna konkrete diskografike (shih Bala 2000). Për t’u shënuar këtu mbase është edhe Minga (2020), e cila shtron një qasje reflektive mbi regjistrimin tingullor dhe arkivin, pavarësisht se nuk prek çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me diskografinë.

njohura. Por fjala këtu është për *institucionalizimin* e disiplinës, me formalizimin e saj si fushë kërkimore pranë një institucioni siç ishte Instituti i Folklorit (1960) e më vonë Instituti i Kulturës Popullore, me organet e veta botuese dhe me ndarjen e organizuar të punës për të mbuluar të gjithë fushën. Gjithsesi, në periudhën e mëparshme nuk ka asnjë autor që t’i ketë kushtuar vëmendje diskografisë.

- 2 “La Voce del Padrone” ishte filiali italian i “His Master’s Voice”, emri që *The Gramophone Company*, kompania më e fuqishme diskografike e kohës, përdori nga viti 1910 e më tej (Racy 1976, 31). Për një ide mbi strukturën globale të saj, shih Gronow 1983, 57.
- 3 Puna mbi disqet e regjistruara nga këngëtarët lirikë shqiptarë në vitet 1930-1940-të përbën një çështje më vete dhe nuk është pjesë e këtij shqyrtimi.

2. Industria e regjistrimit mbërrin në Shqipëri

Industria e regjistrimit muzikor hodhi rrënjë në kapërcyell të shek. XIX.⁴ Që në fillim, kompanitë kryesore punuan fort për ta shtrirë biznesin e tyre në të gjithë globin dhe brenda dhjetëvjeçarit të parë të shek. XX, vështirë se kishte ndonjë vend ku ajo të mos kishte mbërritur me produktet e veta (Gronow 1983, 56). Strategjia bazë ishte joshja e publikut me muzikë vendase. Për t'iu përgjigjur kësaj nevojë, kompanitë dërguan në të katër cepat e botës teknikë regjistrimi, të cilët udhëtonin vend më vend së bashku me pajisjet e tyre duke regjistruar artistë lokalë. Matricat dërgoheshin pastaj në fabrikën që mbulonte rajonin përkatës, në të cilën do të prodhoheshin disqet (Perkins et al 1976; Gronow 1981).

Veçanërisht për tregje të vogla, një qasje e tillë mund të duket jo efikase nga pikëpamja e rentabilitetit. Duhet patur parasysh, megjithatë, se kompanitë nuk tregtonin vetëm regjistrimet (në fillim cilindra e më vonë disqe) por edhe pajisjet për t'i luajtur ato, dhe të paktën në këtë periudhë të parë, regjistrimet shërbenin më tepër si një ndihmesë për të shitur pajisjet përkatëse (Gronow 1983, 55; Jones 1985, 84). Shitjet mesatare të disqeve duket të kenë qenë relativisht të ulëta. Kompanitë përgjithësisht ishin më se të kënaqura me shitjen e pak mijë kopjeve, dhe për të hapur një treg të ri, shitja e pak qindra kopjeve mund të ketë qenë krejt e pranueshme (Gronow 1983, 60). Në këtë kontekst duhet shpjeguar fakti, në pamje të parë befases, se një grup etnik i vogël dhe i pazhvilluar si shqiptarët u bë subjekt regjistrimi që në fazat e hershme të zhvillimit të industrisë.

Në të vërtetë, regjistrimet më të hershme të muzikës tradicionale shqiptare nuk u kryen nga kompani diskografike por janë regjistrime terreni të bëra nga etnografi gjerman Paul Traeger. Në një prej ekspeditave të tij në Shqipëri, atë të vitit 1903, ai bëri rreth 26 regjistrime muzikore në cilindra fonografi në Shkodër, Lezhë dhe Mirditë, të cilat ruhen sot e kësaj dite në Phonogramm-Archiv të Berlinit.⁵ Fonografi ishte shumë i përshtatshëm për punën në terren, pasi mundësonte lehtësisht regjistrimin dhe riprodhimin e tingullit, nuk kishte nevojë për elektricitet dhe ishte i lehtë për t'u mbartur (Ziegler 2020, 139). Por disqet e gramafonit ofronin cilësi tingullore shumë më të mirë sesa cilindrata e fonografit. Prandaj, industria e regjistrimit e zhvendosi shpejt prodhimin e vet drejt disqeve, pavarësisht shkallës së lartë të ekspertizës që kërkohej për të arritur rezultate të mira në regjistrim (Gronow 1981, 253) dhe vështirësive që shkaktoheshin në rastin e vendeve periferike si Shqipëria.

4 Duke lënë mënjanë kompanitë Amerikane, në Europë, për shembull, *Pathé* u themelua në Francë më 1897, *The Gramophone Company* në Angli dhe *Deutsche Gramophon AG* në Gjermani u themeluan më 1898 (shih Gronow 1983, 55).

5 Regjistrimet në fakt janë 28, por dy prej tyre janë recitime tekstesh, ndërsa 26 janë njësi mirëfilli muzikore, vokale dhe instrumentale. Për më gjerësisht, shih Ahmedaja 2012.

Nuk ka të dhëna të sigurta se kur hyri gramafoni për herë të parë në Shqipëri. E dhëna më e hershme që kemi mundur të gjejmë në shtypin e kohës, lidhet me një njoftim për praninë e një mjeshtri në Shkodër për rregullimin e gramafonëve.⁶ Edhe përsa i takon regjistrimeve, burimet dokumentare janë mjaft të pakta. Sipas një burimi, kompania *Favourite* bëri disa regjistrime shqiptare që më 1904 (shih Vernon 2021, 5). Pa të dhëna të mëtejshme ama, nuk mund të thuhet nëse ato janë kryer në një ekspeditë në Shqipëri apo në qendra të tjera urbane të rajonit ose më gjerë.⁷

Nga puna e bërë me dokumentet e *Gramophone Company*, e cila jo vetëm ishte më e madhja por është edhe më e mirëdokumentuara (Gronow 1981, 252), vërtetohet se më 1908 u bë një ekspeditë regjistrimi në Shkodër (shih Perkins et al. 1976, 87⁸), në të cilën u regjistruan rreth 82 njësi. Kjo mund të konsiderohet si ekspedita më e hershme e dokumentuar deri më tani në Shqipëri e një kompanie diskografike.

3. Ekspedita e vitit 1908

Më 1907, dega gjermane e *The Gramophone Company*, duke e parë Bosnjën (asokohe nën administrimin austro-hungarez) si një treg premtues, dërgoi inxhinierin Franz Hampe për të bërë regjistrimet e para të pllakave të gramafonit në Sarajevë (Pennanen 2007, 115). Meqenëse kompania nuk i konsideroi të mjaftueshme për tregun boshnjak 240 njësitë e regjistruara, një vit më vonë ajo dërgoi vëllaun tjetër Max Hampe⁹ për të bërë regjistrime të mëtejshme (*ibid.*, 128). Kjo ekspeditë e dytë pati në fakt një shtrirje më të gjerë, me një itinerar si vijon: Budapest, Zagreb, Sarajevë, Mostar, Sarajevë, Ljubjanë, Mal i Zi dhe Shkodër¹⁰ (shih Perkins et al. 1976, 87). Duket qartë se fokusi i saj ishte në tregun e sllavëve të jugut përgjithësisht. Në këtë kuptim, nuk mund të dihet me siguri nëse udhëtimi në Shkodër ishte i planifikuar paraprakisht, apo erdhi si rrjedhojë e ndonjë rrethane të caktuar gjatë ekspeditës. Sido që të jetë kjo, me rëndësi mbetet fakti që muzika tradicionale shqiptare po regjistrohej dhe po hynte në agjendën e industrisë diskografike.

Për shkak të mungesës së shtypit periodik lokal në atë kohë, nuk ka të dhëna se kur mbërriti në Shkodër saktësisht Max Hampe. Dihet se më 2

6 Shih, *Bashkimi*, 03.07.1910, f. 4.

7 Për arsye historikisht të kuptueshme, regjistrime shqiptare janë realizuar edhe në mjaft vende të tjera, si Greqi, Turqi, Amerikë, etj.

8 Falënderoj studiuesin Fatos Dibra për ndihmën në sigurimin e këtij materiali.

9 Gjatë kësaj ekspedite, Max Hampe u shoqërua nga Friedrich Konrád, punonjës i degës së Budapestit të Gramophone Company, i cili me sa duket u mor më tepër me pjesën e marketingut (shih Pennanen 2007, 128).

10 Në regjistër është shënuar me emërtimin italisht, Scutari.

prill ai ishte në Sarajevë (Pennanen 2007, 128). Më pas ai zbriti në jug drejt Malit të Zi, dhe nga data 27 prill deri më 3 maj qëndroi në Cetinje (*ibid.*, 130). Që këtej, me siguri ai ka vijuar më në jug drejt Shkodrës. Meqenëse stacioni tjetër i njohur i tij ishte largimi nga Sarajeva më 15 maj (*ivi*), mund të konkludohet se qëndrimi në Shkodër ka ndodhur diku ndërmjet datave 4 dhe 14 maj. Nisur nga numri prej rreth 82 njësisish që ka regjistruar, mund të hamendësohet se Max Hampe nuk ka qëndruar në qytet më shumë se 5-6 ditë. Prandaj mund të pohohet me njëfarë besueshmërie se regjistrimet në Shkodër janë kryer diku ndërmjet 4-10 maj 1908.

Tabela në vijim paraqet listën e plotë të këtyre regjistrimeve. Ajo është përpiluar duke u mbështetur në koleksionin e disqeve që gjendet në Muzeun Historik “Oso Kuka” në Shkodër,¹¹ në bashkërendim me një listë të matricave të Gramophone Company, për të cilën studiuesi Allan Kelly është mbështetur në regjistrat e kompanisë.¹² Po ashtu është shfrytëzuar edhe një katalog i vogël (Fig. 1) me rreth 36 tituj i botuar nga dega e Budapestit e kompanisë, e cila ishte përgjegjëse për Ballkanin.¹³



Fig. 1.
Faqja e parë e katalogut
të këngëve shqiptare të
Gramophone Company

- 11 Falënderoj drejtorin Sokol Parmeza dhe punonjësën Ndriçim Mlika për mundësimin e punës me këtë koleksion.
- 12 Lista e përpiluar nga A. Kelly me të dhënat e matricave nga regjistrat e kompanisë janë përfshirë nga: https://www.gramophonecompanydiscography.com/advanced_search_results?artist=&artistAlt=&title=&titleAlt=&prefix=&suffix=&matrixNumber=&issueNumber=&recordingDate=&location=Albania&filename=&other=¬es=&maxResults=1000, konsultuar për herë të fundit më 30.09.2023.
- 13 Falënderoj përzemërsisht studiuesin Hugo Strötbaum, i cili më vuri në dispozicion këtë dokument.

Titujt e këngëve janë saktësuar duke u nisur nga repertori i dokumentuar i qytetit të Shkodrës, por në disa raste nuk ka qenë e mundur që të jepet një interpretim i sigurt i titullit apo ndonjë aspekti tjetër të njësisë së regjistruar. Nëse merret parasysh mosnjohja e shqipes nga personat përgjegjës në të gjitha fazat e prodhimit të disqeve, fakti që vetë shqipja në atë kohë nuk kishte një sistem të përcaktuar drejtshkrimor, etj., kjo gjë është e kuptueshme.

Tabela nr. 1. Regjistrimet e bëra në Shkodër nga Max Hampe më 1908

Nr. i matricës ¹⁴	Prapa-shtesa	Interpretuesi	Titulli	Nr. i diskut ¹⁵
4562	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave ¹⁶	<i>Bijshin dy kavajas n'Ulqin</i>	10763
4563	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Elifet zamani u marue</i>	10764
4564	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Oh bre det o ujë i njelmët</i> ¹⁷	10765
4565	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Ç'mu dhimbte bre çun</i> ¹⁸	10766
4566	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Kanga e heqimit</i> ¹⁹	10767
4567	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>N'Shkodër tonë ka ra një dritë</i> ²⁰	10768
4568	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Me dymbëdhjetë mekame qi janë</i> ²¹	10769
4569	r	Nuk lexohet	Nuk lexohet ²²	10770

14 Numri i matricës gjendet i shtypur në disk dhe përdorej nga kompanitë për të kontrolluar procesin e prodhimit të disqeve. Këta numra janë themelorë për të identifikuar vitin e prodhimit të disqeve.

15 Numri i diskut ose i botimit të diskut nganjëherë shtypej gjithashtu në disk, por gjendet po ashtu edhe në etiketën e diskut. Ai përdorej nga kompanitë për të kontrolluar procesin e shpërndarjes/shitjes, dhe ishte numri që shfaqej zakonisht në katalogët e kompanive.

16 Në disk: Companija Hengcive-Schahirave.

17 Në disk: *Oh bre ded o uj gnelm.*

18 Në disk: *Mulimte bre cun.*

19 Në disk: *Canka e Hegimit.*

20 Në disk: *Nskoder ton kara gni drit.*

21 Në disk: *Me dūmlet Mekamet qi jon.*

22 Siç do të argumentojmë më poshtë, ka shumë mundësi që këtu bëhet fjalë për këngën Fol moj Mine fol, të interpretuar nga po i njëjti grup, Shoqnia e ahengxhijve dhe shahirëve.

4570	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Kanga e Oso Kukës</i> ²³	10771
4571	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Elif allah çun ç'u maru</i> ²⁴	10772
4572 (?) ²⁵	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Kanga e Ali Pashës</i> ²⁶	10773
4573 (?)	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Pika mu m'goditi sot</i> ²⁷	10774
4574	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Gel Mustafa</i> ²⁸	10775
4575	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Mori lule moj burbuqe</i> ²⁹	10776
4576 (?)	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Iptida du me fillu</i>	10777
4577 (?)	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Moj e vogël si florini</i> ³⁰	10778
4578 (?)	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>More kaurri i Venedikut</i> ³¹	10779
4579 (?)	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Si t'kam dashtë unë ty</i> ³²	10780
4580	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>N'at' penxhere kafazli</i> ³³	10781
4581	r	Shoqnia e hengxhive e shahirave	<i>Gjylvatani</i> ³⁴	10782

23 Në disk: *Chenga e Oso Kuks*.

24 Në disk: *Elifala Cun Cumaru*.

25 Kënga është gjetur vetëm në katalog. Meqenëse në katalog nuk jepen numrat e matricave, ajo është vendosur këtu me pikëpyetje, pavarësisht se nisur nga rregullsia e numërimit, me siguri numri identifikues duhet të jetë i saktë. Kështu është vepruar për të gjitha këngët që janë gjetur vetëm në katalogun e kompanisë.

26 Në katalog: *Chanka Ali Pases*.

27 Në katalog: *Pika mu m'goditi sot*.

28 Në disk: *Geler Mustafa* dhe mund të përkthehet "Eja Mustafa".

29 Në disk: *Mori lule moj berbugje*.

30 Në katalog: *Moi evoghel si florini*.

31 Në katalog: *More Chauri Venedikut*.

32 Në katalog: *Si tkam daset un tûû*.

33 Në disk: *N'at penxhere kafazli*.

34 Në disk: *Gjylistan*.

4582	r	Beqir Mustafa (Ramo Muhamedi) ³⁵	<i>Lulja e allit</i> , zurna e lodër, me këndu ³⁶	5-12792
4583	r	Beqir Mustafa (Ramo Muhamedi)	<i>Jasaman moj Bakushe</i> , zurna e lodër, me këndu ³⁷	5-12793
4584	r	Beqir Mustafa (Ramo Muhamedi)	<i>Qerimeja</i> , zurna e lodër, me këndu ³⁸	5-12887
4585	r	Beqir Mustafa (Ramo Muhamedi)	<i>More toska i Beratit</i> , zurna e lodër, me këndu ³⁹	5-12888
4586	r	Pashko Matia ⁴⁰	<i>Gjerdani gielmes</i> [?!] ⁴¹	5-12926
4588	r	Pashko Matia	<i>Ovardajëm, ovarda</i> ⁴²	5-12794
4589	r	Pashko Matia	<i>Iptida moj lulja e allit</i> ⁴³	5-12795
4590	r	Pashko Matia	<i>Karimani jok mardaj</i> [?!] ⁴⁴	5-12796
4591	r	Pashko Matia	<i>Urdhnoni zotni e merrni</i> ⁴⁵	5-12797
4592	r	Pashko Matia	<i>Si vjen devri e zamani</i> ⁴⁶	5-12883
4593	r	Pashko Matia	<i>Hajde lale me raki</i> ⁴⁷	5-12884
4594	r	Pashko Matia	<i>Dalin çunat prej mejtepit</i> ⁴⁸	5-12885

35 Në listën e A. Kelly: Betsir Mustafa (Rahmo Mahomed). Në katalog: Betsir Mustafa e Rahmo Mahmud.

36 Në listën e A. Kelly: *Lulja alit*, Zurna e luder mechnu.

37 Në listën e A. Kelly, titulli është shënuar: *Tosaman moé bausce*.

38 Në katalog, titulli është shënuar: *Cerimeja*.

39 Në katalog: *More toska iberalit*.

40 Në listën e A. Kelly: Pasko Matia.

41 Në disk: *Gier dani gielmes*, ndërsa në dokument: *Gerdami zulmes*. Në ahengun shkodran gjendet një këngë me titull *Shpirt o gajtani kermez* (shih Gurashi 1955, 82; Ballgjati 2021, 160), por nga krahasimi me regjistrimin zanor përkatës del se nuk bëhet fjalë për të njëjtën këngë. Nuk mund të përjashtohet që titulli të jetë në gjuhën turke, nisur nga “gjerdani” (tur. *gerdani*) dhe prapashtesa mohuese “-mes”, “-mez” e fjalës së dytë “gelmez” e cila mund të përkthehet si “nuk vjen”.

42 Në disk: *Ovardaim, ovarda*. Bëhet fjalë për një këngë në turqisht me titull *Hovardayım, hovarda*, e cila mund të përkthehet: Jam çapkën.

43 Në listën e A. Kelly: *Tfidaj moj lulja Alit*.

44 Në listën e A. Kelly: *Kari Mami gjok Mardaj*. Ka gjasa që pjesa e parë e titullit është në turqisht dhe mund të zbërthehet si “Karı imanı yok”, që do të thotë “Gruaja s’ka besim, nuk është besimtare”, me nënkuptimin që “nuk është besnike, nuk është për t’i zënë besë”. Ndërsa termi i fundit nuk ka qenë e mundur të zbërthehet në këtë linjë. Nuk përjashtohet që të jetë përzierje në shqip, me “mar dajë” si dialektorja lokale e thirrme “more dajë”.

45 Në listën e A. Kelly: *Urnoni zotni e nusni*.

46 Në listën e A. Kelly: *Sivijn devri e Zamani*.

47 Në listën e A. Kelly: *Ade lale me raki*.

4595	r	Shtjefën Jakova ⁴⁹	<i>Iku zogu, ra te fiku</i> ⁵⁰	5-12798
4596	r	Shtjefën Jakova	<i>Elif hiqmet që baj unë</i> ⁵¹	5-12799
4597	r	Shtjefën Jakova	<i>Po ndigjo more Hasan</i> ⁵²	5-12881
4598	r	Shtjefën Jakova	<i>Ma gëzofsh shaminë e kuqe</i> ⁵³	5-12882
4599	r	Gaspër Leci ⁵⁴	<i>Ditën e suzit të masherit</i> ⁵⁵	5-12800
4600	r	Gaspër Leci	<i>Ç'janë këto bajrakë të bardhë</i> ⁵⁶	5-12801
4601	r	Gaspër Leci	<i>Të mërkuren n'dy sahati</i> ⁵⁷	5-12802
4602	r	Gaspër Leci	<i>Njatje poshtë te mullini</i> ⁵⁸	5-12803
4603	r	Gaspër Leci	<i>Karajfili kuq si gjaku</i> ⁵⁹	5-12804
4604	r	Gaspër Leci	<i>Moj e mirë synin larushë</i> ⁶⁰	5-12805
4605	r	Gaspër Leci	<i>Maraku ma i randë se plumbi</i> ⁶¹	5-12877
4606	r	Gaspër Leci	<i>Me elif bejten e parë</i> ⁶²	5-12878
4607	r	Gaspër Leci	<i>Brahim Uka djalë jaran</i> ⁶³	5-12879
4608	r	Gaspër Leci	<i>Hajdari si peni</i> ⁶⁴	5-12880
4609	r	Losh Deda (malësor) ⁶⁵	<i>Nush Mria pelivani</i> ⁶⁶	5-12806

48 Në listën e A. Kelly: *Dali innat pre Metepit.*

49 Në listën e A. Kelly: Stefen Jacova.

50 Në listën e A. Kelly: *Tku zogu rate fiku.*

51 Në listën e A. Kelly: *Elif hricmet Cibaiun.*

52 Në listën e A. Kelly: *Ponighir More asan.*

53 Në listën e A. Kelly: *Maghesos samën e Cucie.*

54 Në listën e A. Kelly: Gaspar Lezzi.

55 Në listën e A. Kelly: *Diken e rusit mars cenit.*

56 Në listën e A. Kelly: *Cia jan kto bairakt e barl.*

57 Në listën e A. Kelly: *Te souzeuron ndü sahatin.* Kënga njihet ndryshe edhe si kënga e Oso Kukës.

58 Në listën e A. Kelly: *Gnia tie post le mulini.* Kënga njihet ndryshe edhe si kënga e Rexhep Gërçarit.

59 Në listën e A. Kelly: *Caraifili eng si giacu.*

60 Në listën e A. Kelly: *Moi e mir Sienin Carusok.*

61 Në listën e A. Kelly: *Maraku mai ron seplumi.*

62 Në listë: *Me elif bejten e par.*

63 Në listë: *Brahim Uka dial iuran.*

64 Në listë: *Haidari si peni.* Me siguri bëhet fjalë për këngën *Hajdari, Hajdari* (shih Ballgjati 2021, 414).

65 Në listë: Losch Deda (Malisor).

66 Në listë: *Nuscemeria Pelivani.*

4610	r	Losh Deda (malësor)	<i>Ali Pashë Gucia</i> ⁶⁷	5-12807
4611	r	Losh Deda (malësor)	<i>Ky Gjini Leka ça po ban</i> ⁶⁸	5-12873
4612	r	Losh Deda (malësor)	<i>Nok Gjonit</i> ⁶⁹	5-12874
4613	r	Losh Deda (malësor)	<i>Kanga e unazës</i> ⁷⁰	5-12875
4614	r	Losh Deda (malësor)	<i>Kapidani kuvend me mbretin</i> ⁷¹	5-12876
4615	r	Losh Deda, Ndue Ndreca ⁷²	<i>Kolë Nikë Shala</i> ⁷³	2-14177
4616	r	Losh Deda, Ndue Ndreca	<i>Ndue Gjoni vesh jelekun</i> ⁷⁴	2-14178
4617	r	Hamz Grimci (Shkodër) ⁷⁵	<i>Nuk kam hat me t'dashtun ty</i> ⁷⁶	
4618	r	Hamz Grimci	<i>Elif shokë si i bahet hallit</i> ⁷⁷	5-12789
4619	r	Hamz Grimci	<i>Po të pres te dega e manit</i> ⁷⁸	5-12790
4620	r	Hamz Grimci	<i>Mora avdes me falë sabahin</i> ⁷⁹	5-12791
4621	r	Hamz Grimci	<i>Moj Xhemile ku t'zu hylli i dritës</i> ⁸⁰	5-12886
4622	r	Valle shqiptare (Shkodër) ⁸¹	<i>Mori drandofillja e bardhë</i> ⁸²	2-14619
4623	r	Valle shqiptare (Shkodër)	<i>Lan vasha</i> ⁸³	2-14620
4623 ½	r	Valle shqiptare (Shkodër)	<i>Lan vasha</i>	2-14620X
4624	r	Valle shqiptare (Shkodër)	<i>Shkova me pre një gem kumbull</i> ⁸⁴	2-14621
4625	r	Valle shqiptare (Shkodër)	<i>Ç'po çon era pluhun-o, moj syzezë</i> ⁸⁵	2-14622

67 Në listë: *Ali Pase Gusia*.

68 Në listë: *Eu Gjin Lecca cia cafan*.

69 Në listë: *Niok Gjonit*.

70 Në listë: *Changha Unases*.

71 Në listë: *Chapitan Ghuven me Meretin*.

72 Në listë: *Losch Deda, Nu Nerezza*.

73 Në listë: *Chol Nick Sciala*.

74 Në listë: *Nu Gioni vesce Jelekum*.

75 Në listë: *Hams Grimsi (Skutari d'Albania)*.

76 Në listë: *Kak kam me dasc un tei*. Kënga njihet edhe me titullin *Nuk kam hak me t'dashtun ty*.

77 Në listë: *Elif Sciok sū baet hali*.

78 Në listë: *Poti pres khi dikau manit*.

79 Në listë: *Mura ofdes me falj sabajn*.

80 Në listë: *Moi gjimile cut lea hūli driko*.

81 Në listë: *Vale Scuptare (Skutari d'Albania)*.

82 Në listë: *Moritrana fila barde*.

83 Në listë: *Lan Vassa*.

84 Në listën e A. Kelly: *Scova me pre ni gem kumulj*.

85 Në listën e A. Kelly: *Cpacian era plun o ma su ses*.

4626	r	Valle shqiptare (Shkodër)	<i>E bukura nën fojletë</i> ⁸⁶	2-14623
4627	r	Valle shqiptare (Shkodër)	<i>Qyqja unë e mjera</i> ⁸⁷	2-14624
4628	r	Regjimenti i këmbësoresisë nr. 68, Armata III Turke, Shkodër ⁸⁸	<i>Sultani marsh</i> ⁸⁹	2-10115
4629	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Melodi shkodrane, shqiptare</i> ⁹⁰	2-10116
4630	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Marshi i regjimentit 68</i> ⁹¹	2-10117
4631	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Këngë në suzinak, me zurna</i> ⁹²	2-10118
4632	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Marsh me melodi kantosh</i> ⁹³	2-10119
4633	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Düştüm meraka aşka ben</i> ⁹⁴	2-10120
4634	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Askerî: Mecidiye marşı, I [?!]</i> ⁹⁵	2-10121
4635	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Askerî: Mecidiye marşı, II [?!]</i> ⁹⁶	2-10122

86 Në listën e A. Kelly: *E bukura ne folet*. Bëhet fjalë për vallen *Moj e bukura nën fojletë*.

87 Në listën e A. Kelly: *Sycia una e miera*.

88 Në listën e A. Kelly: Régiment d'Infanterie No 68, 3 Armée de Turc, Scutari.

89 Në listën e A. Kelly: *Soultami marche*.

90 Në listën e A. Kelly: *Scodra, arnaufe havasi*. Në turqisht: *İşkodra, arnavut havası*, që e përkthyer fjalë për fjalë do të thotë "Shkodër, melodi shqiptare".

91 Në listën e A. Kelly: *68 Régiment Marche*.

92 Në listën e A. Kelly: *Souzinayne charki, gournale*. Në turqisht: *Suzinak şarkı, zurna ile*, që mund të përkthehet afërsisht si "Këngë në makamin suzinak, me zurna".

93 Në listën e A. Kelly: *Kantolar Marche*. Në turqisht: *Kantolar marşı*. "Kanto" ishte një zhanër në frymën e melodive të operetave dhe vodëvileve i cili gjeti mjaft popullaritet në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX në Perandorinë Osmane.

94 Në listën e A. Kelly: *Duchtume maragi achka ben*. Duket të jetë aranzhim për bandë i ndonjë kënge, titulli i së cilës mund të përkthehet: "Rashë në dashuri".

95 Në listën e A. Kelly: *(Aszneri:) usme guidjite marchi, I*. Në leximin tonë, këtu bëhet fjalë për "Marshin e Abdulmexhitit". Në Perandorinë Osmane nuk kishte një himn të vetëm shtetëror; por secili sulltan kishte himnin përkatës. Gjasat janë që ky numër të jetë marshi i sulltanit në fjalë.

96 Për vetë kohën e kufizuar prej tre minutash që mund të regjistrohej në një disk në këtë kohë, mund të thuhet me siguri se marshi në fjalë është regjistruar në dy disqe dhe numri aktual është thjesht vazhdimi i të mëparshmit dhe jo ndonjë marsh tjetër me të njëjtin titull.

4636	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Arnavut kant</i> ⁹⁷	2-10131
4637	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Inre ste [?!] kanto, Aşkınla yanayım</i> ⁹⁸	2-10132
4638	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Pencerede ne karzneli [?!]</i> ⁹⁹	2-10133
4639	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Türk şarkı</i> ¹⁰⁰	2-10134
4640	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Marsh turk</i> ¹⁰¹	2-10135
4641	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Can oğlan</i> ¹⁰²	2-10136
4642	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Gör etmedi zalim</i> ¹⁰³	2-10137
4643	r	Regj. 68, Arm.III Turke, Shkodër	<i>Beyaz şemsiyeyle</i> ¹⁰⁴	2-10138

Është interesante se një njësitë 4562r-4581r nuk figurojnë në listën e matricave të hartuar nga regjistrat e kompanisë. Ato janë qëmtuar nga puna me disqet në Muzeun Historik të Shkodrës. Disqet me numrat 4572r-4573r, 4576r-4577r dhe 4578r-4579r nuk janë gjetur fizikisht, por shënohen në katalogun e botuar nga dega e Budapestit. Siç është cekur edhe më lart, katalogët nuk i shënonin numrat e matricave, prandaj në tabelë atyre u është shtuar shenja (?). Nga lista mungon matrica nr. 4587r. Shtesa “½” e matricës 4623r tregon se për një arsye apo një tjetër është bërë një regjistrim i dytë i po asaj valleje, dhe pra bëhet fjalë për një njësi të vetme. Nisur nga këto të dhëna, del se numri i regjistrimeve të ekspeditës në fjalë është 82. Nuk përjashtohet mundësia që të ketë edhe ndonjë regjistrim tjetër përpara 4562r, çka potencialisht do ta rriste këtë numër edhe më tej.

97 Në listën e A. Kelly: *Arnante kant*. Mund të përkthehet si “Këngë shqiptare”.

98 Në listën e A. Kelly: *Inre ste kanto, uchkirle ianaim*. Duket se bëhet fjalë gjithashtu për një aranzhim të një kënge, titulli i së cilës mund të përkthehet: “U djegsha në dashurinë tënde”. Frazja e parë “Inre ste” nuk ka qenë e mundur të zbërthehet.

99 Në listën e A. Kelly: *Pendjere dene kar zneli*. Me gjasë, aranzhim i një kënge; titulli nuk ka qenë e mundur të zbërthehet plotësisht.

100 Në listën e A. Kelly: *Turcate charki*, dmth, “Këngë turke”.

101 Në listën e A. Kelly: *Marche turc pour marche*.

102 Në listën e A. Kelly: *Canre oglon, kant*, dmth, “Djalë i dashur, këngë”.

103 Në listën e A. Kelly: *Sharki turk, guer et medi Zalim*, çka mund të përkthehet afërsisht: “Këngë turke; S’mi hodhi sytë mizorja”

104 Në listën e A. Kelly: *Bejas semsiele kant turk*, çka mund të përkthehet afërsisht: “Me ombrellë të bardhë; këngë turke”.

Disqet janë me regjistrime në të dy anët,¹⁰⁵ janë në formatin 25.4 cm (ose 10 inç, sipas formatit të kompanisë) dhe me etiketë ngjyrë kafe. Të dhënat janë shtypur me ngjyrë ari dhe konsumi i kohës sikurse afërsia e ngjyrës mes letrës e shkronjave ka bërë që një pjesë e mirë e etiketave të lexohen sot me vështirësi. Një prej ekzemplarëve më të qartë jepet në Fig. 2.



Fig. 2.

Interesant është se titulli i këngës dhe interpretuesit përveçse me alfabet latin janë përcjellë edhe me alfabet arab, çka i përgjigjet kontekstit të kohës kur vendi ishte ende nën sundimin osman. Po ashtu tërheq vëmendje përdorimi i italishtes jo vetëm për vendin (Skutari d'Albania) por edhe për gjuhën (Albanese). Nuk mund ta dimë me siguri nëse kjo buron ngaqë ndërmjetësi shqiptar i regjistrimeve mund të ketë komunikuar nëpërmjet italishtes, apo thjesht nga vlerësimi i kompanisë se italishtja mund të ishte më e kuptueshme për blerësin potencial vendas të disqeve.

105 Kjo risi që paraqitur për herë të parë vetëm katër vite më herët nga kompania *Odeon* në Gjermani (shih Racy 1976, 25).

4. Mbi protagonistët dhe repertorin e regjistruar

Përgjigja ndaj shijeve lokale ishte faktori kyç për depërtimin e suksesshëm në treg të kompanive diskografike. Veçanërisht për kultura të largëta e të panjohura kjo bëhej një detyrë dyfish e vështirë për specialistët e regjistrimit që ndërmerrnin ekspedita në këto vende, për shkak të mosnjohjes, moskuptimit e nganjëherë edhe nënçmimit të traditave muzikore përkatëse (shih Gronow 1981, 272). Një gjerman pa as më të voglën njohuri për kulturën apo muzikën shqiptare si Max Hampe, për shembull, nuk mund ta dinte se çfarë pëlqente (dhe rrjedhimisht, çfarë kishte më shumë gjasa të blinte të regjistruar në disk) dëgjuesi tipik në Shkodrën e vitit 1908. Prandaj, ashtu si gjithë kolegët e vet (shih Gronow 1981, 273) ai me siguri ka punuar me ndonjë ndërmjetës vendas, jo vetëm për përkthimin, por edhe për kontaktimin e muzikantëve dhe për përzgjedhjen e repertorit. Në mungesë të çfarëdo të dhëne rreth ndërmjetësit (apo ndërmjetësve) vendas të Hampes, le të hedhim një vështrim mbi muzikantët dhe repertorin e regjistruar prej tyre.

Për grupin e parë, *Shoqinë e ahengxhijve dhe shahirëve*, kemi disa të dhëna nga ahengxhiu i vjetër dhe folkloristi Kolë Gurashi. Duke folur për violinistin Xhoxha i Preçit, ai thotë:

“Është i pari që i ka ra violinës në mënyrë të përkryeme. Me profesion ka kenë kundraxhi, zanatë i përhapun shumë në Shkodër. Ka marrë pjesë në bandën muzikore të Palokë Kurtit, ku i binte tamburelit. Mësuesi i parë i tij ka qenë një tiranas me emnin Xhep. Ali Mehi e kishte prue si mjeshtër për të ba aheng në lulishten popullore. U mahnit nga mjeshtëria e Xhepit dhe punoi me shumë pasion për t’u ba edhe vetë i tillë. Për shumë vjet në Shkodër ka kryesue një kuartet të formuem prej tij. Këtu banin pjesë: Ai vetë me violinë, Gjon Shahini me saze, Qorri (Shtjefën Jakova – *shën. im*) me kangë e Filip Koleka me dajre. Kishin dhe një ndihmës kangtar. Kjo quhej shoqnia e ahengçijve dhe e shahirave. Ka marrë pjesë në të gjithë darsmat e festat në Shkodër. Shoqnia e hengçijve dhe e shahirave, ka inçizue në Shkodër pllakat e para të gramafonit. Xhoxh Preçi ka lindë në Shkodër në vitin 1858 dhe ka vdekë në vitin 1918 pa lënë fëmij” (Gurashi 2002, 244).

Që ky ishte një grup mjaft i njohur i ahengut në qytet konfirmohet edhe nga fakti se është i vetmi për të cilin kemi të dhëna se interpretonte rregullisht edhe në lokale të qytetit. Në një njoftim në periodik të Kafe “Sarajevo”, një nga lokalet më me emër në lagjen kryesore të qytetit, lexojmë: “Eheng Komtaar: Xhoxha me shok, për gjith n’e ëjte e n’e djele mrama, prejë sahatit 7 e deri n’11 frengish. Asht i ftuem sejcili me urdhnuë”.¹⁰⁶

Është interesante se megjithëse grupi kishte në përbërje të vet mbase këngëtarin më të vlerësuar të brezit të vet, Shtjefën Jakovën, ai identifikohet

106 *Taraboshi*, 16.04.1914, f. 3.

në radhë të parë me violinistin. Për Jakovën, nga ana tjetër, Kolë Gurashi nënvizon:

“Shtjefën Jakova (i mbi quejtun Qorr Jakova): Nēzanēs i Markut Kranja-nēs, e tenor me nji za t’hall shum melodjoz. ... Ka pasē inçizue disket e parē të gramafonit këtu në Shkodër¹⁰⁷ me kuartetin e tij: Xhoxhën me vjolinë, Gjon Shahinin me saze, e Filip Kolekën me dajre. Disqet kryesore janë: *Ç’mu dhimte bre çun, Fol moj Mine fol, Doktor*,¹⁰⁸ Fillimi i ehengut me kangë qi rrjellin mrapa etj. Me vdekjen e tij ehengu shkodran ka humb ma të mirin interpret,¹⁰⁹ qi dinte me paraqit në vendin qi i përket. Ka vdekun në Shkodër në vobeksi në moshën afro 70 vjeçare, rreth vjetve 1927-28” (Gurashi 1955, 12).

Bie në sy se krahas regjistrimeve në emër të grupit, Jakova ka edhe disa interpretime ku shfaqet me emër të vet (shih nr. 4595r-4598r). Ka shumë mundësi që këto regjistrime të jenë kryer në një seancë të dytë, në një ditë tjetër nga blloku i parë. Me siguri në këto katër këngë Jakova është shoqëruar gjithashtu nga kolegët e vet të grupit, çka e çon numrin e këngëve të regjistruara prej tyre të paktën në tetëmbëdhjetë. Nga krahasimi i këtyre të fundit me të dhënat e lartcituara të Gurashit, mund të supozohet se regjistrimi 4569r mund të jetë kënga *Fol moj Mine fol*.

Emri i këngëtarit Pashko Matia është krejt i panjohur në burimet dokumentore ekzistuese të ahengut shkodran. Fakti që ka regjistruar tetë këngë, nga ana tjetër, dëshmon se edhe vetë Max Hampe e ka konsideruar si interpretues të denjë. Numrat e matricave të regjistrimeve të tij u paraprijnë atyre të Shtjefën Jakovës, dhe me gjasë janë realizuar në të njëjtën seancë. Prandaj mund të supozohet se ai është pikërisht këngëtari ndihmës i grupit të “ahengxhijve e shahirëve” për të cilin bën fjalë Gurashi.

Këngëtari tjetër, Gaspër Leci, i cili ka dhjetë regjistrime, ishte një nga interpretuesit e njohur të ahengut shkodran të brezit të tij. Gurashi thotë shkurtimisht për të: “I biri i Lec Gegës, i kushrini i Zefit Hilë Gegës, lindun në Shkodër e vdekë në Tiranë rreth vjetit 1920 në moshën afro 58 vjeçare. Ka kenë nji bariton shumë i fortë, e ka këndue shumë mirë. Ehengun shkodran e ka njoftë me vend” (Gurashi 1955, 19). Për Hamz Grimcin, i cili ka pesë regjistrime, nuk kemi të dhëna specifike. Gurashi e përmend ndër ata këngëtarë për të cilët nuk ka arritur të mbledhë të dhëna biografike, dhe e rendit në kategorinë që ai e cilëson si “kangatarë tenora diletanta” (*ibid.*, 15). Nuk ka të dhëna për grupin instrumental që mund të ketë shoqëruar

107 Gurashi ka pasaktësi dhe luhatje në datat që jep për këto regjistrime. Fillimisht ka dhënë vitin 1910 (shih Almanaku *Shkodra* 1961, f. 213) ndërsa më vonë jep vitin 1903 (shih Almanaku *Shkodra* 1964, f. 161).

108 Bëhet fjalë për numrin 4566r që këtu është regjistruar si *Kanga e heqimit* (nga tur. *hekim*, dmth, mjek, doktor).

109 Për një analizë të cilësive interpretuese të Jakovës, shih Bala 2000.

këta dy këngëtarë.

Krahas këngëve të ahengut që përbëjnë pjesën më të madhe të regjistrimeve, gjatë ekspeditës u regjistruan edhe gjashtë njësi nga repertori tjetër i rëndësishëm i këngës qytetare të Shkodrës, vallet e kënduara të ceremonialit të dasmës. Mbase për shkak të natyrës së tyre të interpretuar në bashkësi, nuk është përcjellë asnjë e dhënë për interpretuesit e këtyre numrave.

Një befasi e listës së regjistrimeve janë tetë këngët e regjistruara nga një këngëtar i quajtur Losh Deda,¹¹⁰ i cili cilësohet specifikisht si “malësor”. Themi befasi sepse kompanitë diskografike kishin në qendër të vëmendjes repertolet urbane meqenëse edhe klientët e tyre ishin kryesisht shtresat qytetare. Në fakt është e vështirë të imagjinohej blerës pllakash gramafoni në malësitë shqiptare të fillimit të shek. XX. Me sa duket, Losh Deda ka qenë një interpretues mjaftueshëm i mirë dhe repertori i kënduar prej tij mjaftueshëm interesant sa ta bënte Max Hampen që të vazhdonte më tej me regjistrimin.

Beqir Mustafa dhe Ramo Muhameti duket se kanë qenë romë dhe kanë interpretuar në ansamblin tipik me lodër e zurna. Fakti që në secilin prej regjistrimeve të tyre shënohet specifikisht edhe “me këndu”, bën të mendohet se ata nuk interpretonin thjesht në mënyrë instrumentale këngët e përzgjedhura (siç ndodh zakonisht me këtë lloj ansambli), por përfshinin edhe të kënduarit. Ky repertor që do të marginalizohej më vonë si nga kompanitë diskografike ashtu edhe nga studiuesit e muzikës folklorike, në këtë ekspeditë u përfshi me sa duket nisur edhe nga përvoja e mëparshme me Bosnjën (shih Pennanen 2007, 124).

Një bllok më vete e përbëjnë gjashtëmbëdhjetë njësitë e regjistruara nga banda e garnizonit osman në Shkodër.¹¹¹ Ato janë të vetmet që dalin jashtë profilin të muzikës tradicionale. Në fakt, për shkak se ishin formacione shumë të përhapura por edhe për shkak se instrumentet frymore i përshtateshin shumë mirë teknologjisë së regjistrimit akustik, bandat frymore zunë një vend mjaft të rëndësishëm në vitet e hershme të industrisë së regjistrimit (Pennanen 2007, 137). Ajo që befason në këtë rast është se pse u zgjodh të regjistrohej banda e garnizonit osman, ndërkohë që në qytet kishte një traditë të paktën njëzetvjeçare të zhvillimit të këtyre formacioneve.¹¹² Natyrisht, kompanitë diskografike kishin qëllime fitimi

110 Dy këngët e fundit së bashku me një këngëtar tjetër, me siguri po ashtu malësor, të quajtur Ndue Ndreca.

111 Regjistruar në disk si Regjimenti 68 i Këmbësonisë së Armatës III Turke.

112 Nga të dhënat që parashtron studiuesi Tonin Zadeja, vërehet se në këtë kohë ishin të paktën dy banda frymore aktive në qytet, banda e Kishës Katedrale e drejtuar nga Frano Ndoja dhe ajo e Shkollës së Artizanatit e drejtuar nga Palokë Kurti (shih Zadeja 2006, 22-25). Për të parën nga këto kemi dëshmi edhe pamore se vetëm dy muaj më vonë, në korrik të atij viti, ajo dha një koncert publik me rastin e shpalljes së

dhe nuk punonin mbi bazë politikash kulturore. Por, qoftë edhe duke menduar thjesht tregun vendas, regjistrimi i ndonjë prej formacioneve të qytetit mund të ishte konsideruar një investim më premtues. Nga njëra anë, ama, duhet mbajtur parasysh se asokohe nuk kishte ende një repertor të konsoliduar vendas për këto formacione. Nga ana tjetër, repertori osman ofronte mundësinë e qarkullimit në një hapësirë që shkonte shumë përtej asaj lokale të Shkodrës apo edhe hapësirës shqipfolëse në tërësi.¹¹³

Përtej përpunimit të melodive popullore të vodëvileve osmane që zënë një vend të gjerë në repertorin e regjistruar nga kjo bandë, bie në sy edhe lëvrimi i motiveve shqiptare. Dy regjistrime, 4629r dhe 4636r, shënohen përkatësisht si “Melodi shkodrane, shqiptare” dhe “Këngë shqiptare”. Meqenëse nuk disponohen regjistrimet është e pamundur të thuhet diçka konkrete për këto aranzhime dhe këngët apo meloditë mbi të cilat ato mbështeten.¹¹⁴ Gjithsesi me rëndësi mbetet fakti se ky formacion jo vetëm “komunikonte” me peizazhin muzikor vendas por zgjodhi edhe të regjistronte ndonjë nga produktet e këtij komunikimi.

Nga ajo çka na zbulojnë regjistrimet që kemi në shqyrtim, duket qartë se ky peizazh muzikor mbizotërohej nga ahengu. Në fakt, nga 82 regjistrimet e kryera në qytet, 48 janë këngë të ahengut shkodran. Nëse nga totali zbriten 16 regjistrimet e bandës së garnizonit osman apo edhe 8 këngët e malësisë që nuk i përkasin repertorit të qytetit, përpjesëtimi thellohet edhe më tej. Është interesante në këtë drejtim se një autor si Ndre Mjeda poezitë e veprës *Shahiri elierz* do t’i botonte në këtë kohë të organizuara në bazë “hengjesh” (Hengu I, Hengu II, etj),¹¹⁵ duke referuar pikërisht mënyrën si organizohej edhe vetë repertori i ahengut shkodran.¹¹⁶

Për atë sa mund të përgjithësohet nga të dhënat diskografike të përmbledhura më lart, më 1908 gjurmët e arealit të gjerë politik e kulturor osman janë ende relativisht të ndjeshme në aheng dhe procesi i kombëtarizimit nuk kishte përfutur akoma atë dinamikë që do ta shoqëronte

Kushtetutës dhe të drejtave që siguronte ajo për kombësitë e ndryshme në këtë fazë të fundit të sundimit të Perandorisë Osmane në Ballkan (shih Zadeja 2006, 23).

113 Edhe në Bosnjë, e cila nga Perandoria Osmane kishte kaluar tashmë nën administrimin e Perandorisë Austrohungareze, për shkak të trashëgimisë historike, kompania *Gramophone* reklamonte në katalogët e vet edhe një numër të madh regjistrimesh turke krahas atyre boshnjake (shih Pennanen 2007, 128-9).

114 Do të ishte me shumë interes në këtë kontekst të bëheshin krahasime me përpunimet e ngjashme të Palokë Kurtit (shih Zadeja 2006).

115 Shih, *Kalendari 1913*, f. 59.

116 Kolë Gurashi njofton se Dom Ndre Mjeda “ka qenë edhe hengëçi i mirë” dhe se “hëngun shkodran e ka shijue shumë dhe me andje merrte pjesë ndër mbledhje gazmore” (Gurashi 1955, 15). Ndërsa për një shtjellim më të gjerë rreth organizimit specifik të ahengut shkodran, shih Gurashi 1955, 2002, Ballgjati 2021.

në vijim.¹¹⁷ Të paktën dy prej këngëve të regjistruara (4574r¹¹⁸ dhe 4588r) janë kënduar në turqisht, ndërsa dy të tjera (4586r dhe 4590r) ka gjasa gjithashtu të jenë po në atë gjuhë. Këngë të tjera ndonëse janë përkthyer, mbartin ende gjurmë të dukshme të gjuhës së origjinës.¹¹⁹ Këtu po ndalemi vetëm në nivelin gjuhësor pasi regjistrimet tingullore në dispozicion janë të pakta dhe analiza muzikore nga ana e vet do të kërkonte një punim më vete. Sidoqoftë, është e qartë se në këtë kohë praktikat muzikore lokale ishin ende në komunikim të ndërsjelltë (sado asimetrik) me ato të arealit osman përgjithësisht.

Vlen të nënvizohet në kalim se gjatë periudhës socialiste një numër disqesh të koleksionit të Muzeut Historik, Shkodër qenë hedhur në shirit magnetik në Institutin e Kulturës Popullore në Tiranë, me shënimin “Riprodhime nga disqet e Kolë Kakarriqit, Shkodër”. Ato gjenden sot të digjitalizuara në Arkivin Audiovizual të IAKSA. Por nga 38 këngët e ekspeditës së vitit 1908 që përmban koleksioni, rezulton se në shirit janë hedhur vetëm 11 numra.¹²⁰ Edhe nëse lihen mënjane 5 regjistrime të bandës osmane dhe 2 të ansamblit me lodër e zurna që mund të jenë konsideruar si “pa interes” nga punonjësit përgjegjës të kohës, diferenca është gjithsesi e rëndësishme dhe mbetet për t’u shqyrtuar më tej.

5. Mbi qarkullimin e disqeve

Një pikëpyetje me interes në lidhje me regjistrimet e kësaj ekspedite ka të bëjë me faktin se sa kanë qarkulluar ato realisht në shtresat qytetare të kohës. Meqenëse nuk kemi të dhëna të tjera që mund të ndihmonin për këtë periudhë, burimi kryesor mbeten vetë disqet si artefakte. Arkivi më i pasur në këtë drejtim është ai i Muzeut Historik “Oso Kuka” të Shkodrës.¹²¹ Disqet e tij duket se janë sekuestruar gjatë periudhës socialiste nga familje të

117 Le të vërehet, për shembull, qoftë edhe cilësimi si “aheng kombëtar” në njoftimin sipërcituar të vitit 1914.

118 Kjo këngë më vonë do të përshtatej me tekst shqip me titullin *Moj vjollcë je lule* (shih Gurashi 1955, 36; Ballgjati 2021, 47).

119 Këtu i referohemi, për shembull, nr. 4566r e cila sipas Kolë Gurashit ishte një këngë me origjinë turke e “shkodranizuar” nga Shtjefën Jakova (Gurashi 1955, 45). E interpretuar fillimisht si *Kanga e heqimit*, vetëm më vonë ajo do të shndërrohet në “doktor”.

120 Ato janë: 4562r, 4563r, 4566r, 45677r, 4570r, 4571r, 4586r, 4595r, 4596r, 4601r dhe 4602r. Numrat e tyre të bobinave në Arkivin Audiovizual të IAKSA përkatësisht janë: 0279-01; 0278-15; 0279-04; 0279-05; 0279-03; 0279-02; 0283-02; 0278-13; 0278-14; 0279-06 dhe 0279-07.

121 Në Arkivin Audiovizual të IAKSA, ndonëse ka një fond me disqe gramafoni, nuk ka asnjë ekzemplar nga ekspedita e vitit 1908 të *Gramophone Company*. Nga ana tjetër, ka të dhëna për ndonjë arkiv privat, por në pamundësi konsultimi nuk mund të hedhim ndonjë hap më tutje në këtë drejtim.

pasura të qytetit. Pjesa më e madhe e fondit buron nga familja Kakarriqi,¹²² por ka një numër disqesh edhe me etiketën “Saraçi” çka nënkupton me siguri familjen që i zotëronte dikur.

Nga 95 disqe që ka gjithsej fondi rreth 19 janë me regjistrime të kësaj ekspedite. Me fjalë të tjera, nga 82 njësitë e regjistruara fillimisht, pothuajse gjysma (38 njësi) gjenden akoma në disqet e arkivit në fjalë. Kjo është një shifër mjaft e lartë, veçanërisht po të krahasohet me një ekspeditë të ngjashme të zhvilluar më 1929 nga kompania *Odeon* dhe të reklamuar gjerësisht në shtypin e kohës.¹²³ Nga 46 njësitë e regjistruara nga grupi shkodran që shfaqen në katalogun e botuar të kompanisë, në arkiv gjenden vetëm 6 disqe me 12 njësi, pra rreth një e katërta.¹²⁴ Pjesërisht kjo mund të arsyetohet me faktin se në fund të viteve 1920-të, industria e regjistrimit kishte arritur kulmin e zhvillimit të vet (shih Gronow 1983, 62), dhe oferta ishte bërë shumë më e gjerë e më e larmishme edhe për blerësin shqiptar. Këtu duhet të llogaritet gjithashtu edhe joshja specifike e të qenit të parat për regjistrimet e vitit 1908.¹²⁵ Mund të thuhet madje se ky është faktori më vendimtar që shpjegon numrin e konsiderueshëm të disqeve që kanë ardhur deri më sot nga ky korpus.

Në fakt, në këtë fazë të hershme cilësia e regjistrimeve nuk ishte akoma në nivelet më të mira. Në një artikull të vitit 1905, Faik Konica, me humorin e vet aq karakteristik, do ta përmbledhte gjendjen në këtë mënyrë: “sot për sot, për të thënë të vërtetën, zëri i një maqine folëtoje është si zëri i një njeriu që kanë zënë në grykë, i kanë mbyllur gojën dhe e shtrëngojnë të flasë a të këndojë nga hunda.”¹²⁶ Por joshja e rrisë, e të paturit të fjalës së fundit që ofronte moderniteti teknologjik duket se ka qenë mjaft e fortë për shtresat më të kamura të shoqërisë shqiptare të kohës.

122 Shih, Robert Prendushi, “Studime dhe diskotekë e pasur për këngët shkodrane”, *Bashkimi*, 03.04.1988, f. 3. Në fund të viteve 1920-të, njoftohemi se kjo familje kishte ndërtuar një fabrikë të madhe birre në bashkëpunim me një firmë angleze, duke themeluar shoqërinë *Albanian National Brewery Ltd*. Shih, *Posta e Korçës*, 28.11.1929, f. 6.

123 Revista *Leka*, për shembull, në numrin e janarit të vitit 1930, njoftonte: “Perfaksuesit e shoqnis “*Odeon*” vojtën në Tiranë me marrë kangë shqype për gramofon. Thonë se kanë marrë deri në treqind. “*Posta e Korçës*” thotë se, për ket qëllim, kanë shkue prej Shkodrës Pjetër e Nush Bushati, Kolë Lufi, Balto Luka dhe Karlo Pali, të cilët janë në zâ në pikpamje të muzikës komtare” (*Leka*, Janar 1930, f. 29). Njoftime mbi regjistrimet dhe veçanërisht mbi listën e titujve në dispozicion jep më gjerësisht e më në vazhdimësi gazeta *Posta e Korçës*.

124 Në Arkivin Audiovizual të IAKSA nuk gjendet asnjë disk nga kjo ekspeditë.

125 Nuk është pa domethënie në këtë drejtim që Kolë Gurashi përmend vazhdimisht regjistrimet në pllaka gramafoni kur flet për Shjefën Jakovën apo Xhoxhë Preçin, ndërkohë që nuk e përmend këtë fakt për asnjë prej ahengxhinjve të tjerë që kanë regjistruar pas tyre.

126 Faik Konica, “Rota e botës”, *Albania* 1905, nr. 5, f. 96.

Nisur nga konteksti historik, gjasat janë që disqet të mos kenë patur qarkullim të gjerë. Fakti është se në arkivat e qëmtuara ato gjenden vazhdimisht në kopje të vetme; vetëm në dy raste janë identifikuar dy kopje të një disku. Kjo e përforcon më tej idenë e një qarkullimi të kufizuar.

6. Konkluzione

Regjistrimet e vitit 1908 në Shkodër nga *Gramophone Company* janë inçizimet më të hershme të dokumentuara të një kompanie diskografike në territorin shqiptar dhe ndër dokumentet tingullore më të hershme të muzikës tradicionale shqiptare në tërësi. Me sa dihet deri tani, kompanitë e tjera (*Odeon, Columbia*, etj) do ta ndiqnin këtë rrugë vetëm në vitet 1920-të.

Në këtë fazë të dytë, kompanitë do ta zgjeronin procesin e regjistrimit në të gjitha qendrat kryesore urbane shqipfolëse duke iu përgjigjur kështu shijeve e traditave muzikore lokale shpesh mjaft të ndryshme të zonave përkatëse.¹²⁷ Ekspedita e vitit 1908 që shumë më e kufizuar në këtë aspekt, duke qëndruar vetëm në Shkodër. Edhe këtu, ama, vërehet e njëjta politikë e kompanive diskografike për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave të ndryshme të tregut. Krahas këngës qytetare, me këngët e ahengut si tipologjia mbizotëruese por edhe me vallet e kënduara të ceremonialit të dasmës, është dokumentuar gjithashtu edhe kënga e malësisë me disa prej nëntipeve të saj (historike, legjendare, lirike, humoristike), apo edhe repertore tashmë të zhdukura si ai me lodër e zurna.

Repertori muzikor i qytetit siç ravijëzohet në këto regjistrime paraqet vijimësi të dukshme me fazën më të mirëdokumentuar të tij nga vitet 1940-të e këtej. Në një vështrim të kujdesshëm, megjithatë, disa dallime bien në sy. Kështu, tërheq vëmendje se nuk ka asnjë këngë të regjistruar nga jaret e njohura të Palokë Kurtit, të cilat mund të konsiderohen si pika kulmore të ahengut shkodran. Nuk mund të thuhet nëse bëhet fjalë për një shpërputhje ndërmjet vlerës së perceptuar artistike dhe popullaritetit masiv të tyre por çështja është me interes dhe ia vlen të ndiqet më tej.

Ka një numër jo të papërfillshëm këngësh të cilësuar si “elife,”¹²⁸ të cilat sipas studiuesit F. Bala karakterizoheshin nga një vështirësi teknike

127 Njoftimet në shtyp sikurse edhe koleksionet e ndryshme e dëshmojnë qartë një gjedhe të tillë qarkullimi të disqeve me bazë lokale dhe jo kombëtare. Kështu, në koleksionin e familjes Kakarriqi disqet janë në masën dërrmuese me repertor shkodran, ndërsa një koleksion i Kostandin Trakos (një kopje e digjitalizuar e këngëve të të cilit gjendet në Arkivin Audiovizual të IAKSA) ka vetëm repertor të Juglindjes së vendit prej nga e kishte origjinën dirigjenti i njohur. *Gazeta Posta e Korçës* njoftonte vetëm njësitë e regjistruara në Korçë dhe jo të gjithë katalogun e regjistrimeve të Odeon-it (*Posta e Korçës*, 07.12.1929, f. 3), ndërsa revista *Leka*, nga ana e vet, i referohej vetëm përfaqësuesve shkodranë të po asaj ekspedite regjistrimi (shih *Leka*, Janar 1930, f. 29).

128 Numrat 4563r, 4571r, 4596r, 4606r dhe 4618r.

maksimale për interpretuesin (shih Bala 2000). Dihet se nga mesi i shekullit e më tej ato këngë dolën krejtësisht nga qarkullimi, gjë që lidhet, ndër të tjera, me procesin e spastrimit të elementeve të caktuara orientale ose më përgjithësisht me procesin e kombëtarizimit të repertorit. Duke risjellë në vëmendje edhe vëzhgimet gjuhësore të cekura më lart, mund të thuhet se pamja që na servirin regjistrimet nën shqyrtim është ajo e një faze ku ky proces i kombëtarizimit ishte në një stad ende latent. Nevojitet ende shumë punë me regjistrimet tingullore të kompanive diskografike për ta analizuar konkretisht e në imtësi këtë proces.

BIBLIOGRAFI

- A. AHMEDAJA (përg.), *Discovering Albania. Recordings from the collections "Traeger Albanian 1903" and "Stockmann Albanien 1957" of the Berlin Phonogramm-Archiv, Ethnological Museum – Berlin State Museums*, CD dhe boshurë. Ulysses Foundation, Tiranë 2012.
- F. BALA, *Në lulishten e këngës shkodrane dhe të këngëtarëve*, Idromeno, Shkodër 2000.
- V. DIMOV, *Following the black spiral: Old voices, new life. Toward the history of the early commercial gramophone records in Bulgaria*, "Muzikologija" 32 (2022), 19-40.
- E. BALLGJATI, *Ahengju shkodran. Notizimi i plotë* (botim kritik), Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2021.
- P. GRONOW, *The Record Industry Comes to the Orient*, "Ethnomusicology", Vol. 25, No. 2 (1981), 251-284.
- P. GRONOW, *The Record Industry: The Growth of a Mass Medium*, "Popular Music" 3 (1983), 53-75.
- K. GURASHI, *Ehengju shkodran*, Dorëshkrim. Arkivi i Folklorit, IAKSA, kut. 12, dos. 12/9, nr. 972, Tiranë 1955.
- K. GURASHI, *Shkodra e baballarëve*, Botime françeskane, Shkodër 2002.
- R. HYSO, *Mbi incizimet e para të folklorit shqiptar*, "Kultura Popullore" nr. 2, (1985), 171-177.
- G. JONES, *The Gramophone Company: An Anglo-American Multinational, 1898-1931*, "The Business History Review", Vol. 59, No. 1 (1985), 76-100.
- M. MINGA, *Tinguj që rrëfejnë, tinguj që rrëfehen. Elbasani në regjistrimet etnomuzikologjike të arkivit audiovizual-IAKSA*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2020.
- PA AUTOR, *Catalogo gramofono. Dischi a doppia faccia. Albanese*, The Gramophone Company, Budapest 1908.
- PA AUTOR, *Katalogu i këngëvet shqiptare marrë në pllaka gramofoni prej*

- fabrikës "ODEON", Shtypshkronja "Tirana", Tiranë 1930 (?)*.
- R. P. PENNANEN, *Immortalised on Wax. Professional Folk Musicians and Their Gramophone Recordings Made in Sarajevo, 1907 and 1908*, në B. JEZERNIK, R. MURŠIČ, A. BARTULOVIĆ (ed.) *Europe and Its Other: Notes on the Balkans*, Filozofska fakulteta, Ljubljana 2007, 107-148.
- J. F. PERKINS, A. KELLY, J. WARD, *On Gramophone Company Matrix Numbers, 1898 to 1921*, "The Record Collector" 23 (1976), 51-90.
- A. J. RACY, *Record Industry and Egyptian Traditional Music: 1904-1932*, "Ethnomusicology", Vol. 20, No. 1 (1976), 23-48.
- V. TOLE, *Enciklopedia e muzikës popullore shqiptare*, "ILAR", Tiranë 2001.
- V. TOLE, *Sazet e Selimit dhe Hafizesë, e Ajdin Leskovikut*, CD dhe boshurë. Mediaprint, Tiranë 2017.
- P. VERNON, *Ethnic and Vernacular Music, 1898-1960. A Resource and Guide to Recordings*, Greenwood Press, Connecticut 2021.
- T. ZADEJA, *Jeta kulturore e Shkodrës. Mesi i shekullit XIX – Mesi i shekullit XX*, ASMUS, Tiranë 2006.
- S. ZIEGLER, *Historical sound recordings in the Berlin Phonogramm-Archiv and the Lautarchiv*, "Translingual Discourse in Ethnomusicology", 6 (2020), 136-155.